



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/136

Datë: 26.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohen Koncept-dokumentet e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik si në vijim:
 - 1.1. Koncept-dokumenti për hartimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-116 për Ngrohjen Qendrore dhe
 - 1.2. Koncept-dokumenti për hartimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-133 për Gazin Natyror.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/136

Datë: 26.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/136

Datë: 26.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 3 të Ligjit nr. 02/L-25 për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtar në Këshillin Drejtues në Institutin Gjyqësor të Kosovës propozon z. Fekë Sadikaj.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin bashku me biografinë e të propozuarit nga pika 1. t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/136

Datë: 26.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2013, mori:

V E N D I M - P R E L I M I N A R

1. Aprovohet shpronësimi, për interes publik, i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i rrugës Nacionale N9 Fushë Kosovë-Arllat-Gjurgjicë, Segmenti Gjurgjicë-Kijevë, Zonat Kadastrale, Balincë, Llazicë, Mleqan dhe Kijevë të Komunës së Malishevës, sipas tabelave bashkangjitura këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Kuvendet Komunale në territorin e të cilit gjenden ngastrat kadastrale.
3. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që në bashkëpunim me Kuvendet Komunale, brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas aprovimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
4. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/136

Datë: 26.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim, për interes publik, të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Objektivit Administrativ dhe pjesëve përcjellëse për stërvitje dhe trajnime për nevoja të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave/Ministria e Punëve të Brendshme, Zona Kadastrale Hajvali dhe Qagllavicë të Komunës së Prishtinës, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme /Ministria e Financave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/136

Datë: 26.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2013, mori:

V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohen shpronësimet dhe vlerësimet shtesë me interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Vërmicë-Merdarë Sektori 7.3 dhe 8 Zona Kadastrale, Fushë Kosovë, Komuna Fushë Kosovë dhe Zona Kadastrale Uglarë, Komuna Graçanicë, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH në mbështetje të Kuvendeve Komunale në territorin e të cilave gjenden zonat kadastrale, i dërgojnë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas aprovimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat e bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.

5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.
6. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
7. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/136

Datë: 26.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2013, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Planit të dokumenteve strategjike për vitin 2013

1. Në planin e dokumenteve strategjike për vitin 2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihet:
 - 1.1. Projekt-strategjia për të drejtat e njeriut për vitin 2013-2017 (ZKM)
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/136

Datë: 26.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-176 për Turizmin, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli i Turizmit të Kosovës në këtë përbërje:

1.1. Halil Bajrami, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,	kryesues;
1.2. Leonora Shala, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,	anëtare;
1.3. Merita Augustini, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,	anëtare;
1.4. Sami Behrami, Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor,	anëtar;
1.5. Jakup Berisha, Oda Ekonomike e Kosovës,	anëtar;
1.6. Shqipe Arifaj, Asociacioni i Komunave të Kosovës,	anëtare;
1.7. Hasan Krasniqi, ekspert i pavarur,	anëtar.
2. Këshilli i kryen detyrat e parashtruara në nenin 20 të Ligjit nr. 04/L-176 për Turizmin.
3. Sipas nevojës dhe rrethanave, Këshilli mund të kërkojë informata shtesë dhe ekspertizë prej Institucioneve relevante të Republikës së Kosovës.
4. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për sigurimin e hapësirës dhe mbështetjes teknike për Këshillin, me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së tij.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/136

Datë: 26.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme për ndarjen e mjeteve në shumë prej 100,000.00 (njëqind mijë) euro.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë dhe barten në Ministrinë e Punëve të Jashtme, programi Ambasadat me kod 14300, kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodi 130, dhe i destinohen Misionit të Posaçëm të Republikës së Kosovës në Republikën e Serbisë.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/136

Datë: 26.06.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2013, mori:

V E N D I M

1. Për të gjithë përfaqësuesit e ministrive që marrin pjesë në delegacionet e bisedimeve shpenzimet do të barten nga Fondi për Bisedime në Zyrën e Kryeministrit.
2. Obligohen Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë